



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 270/4 Prot

Tiranë, më 07.12.2020

V E N D I M

Nr.170, datë 07.12.2020

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, kryer për verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në procedurën e transferimit të përhershëm të nëpunëses *** , në kuadër të ristrukturimit të Bashkisë Klos.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të nenit 90 të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të informacionit të përcjellë nga Departamenti i Administratës Publike, në lidhje me pretendimet e nëpunëses ***** , për paligjshmëri në procedurën e transferimit të përhershëm, në kuadër të ristrukturimit të Bashkisë Klos,

VËREJ SE:

Nëpërmjet shkresës nr. 270 prot., datë 17.04.2020, Departamenti i Administratës Publike ka informuar Komisionerin në lidhje me ankesën e paraqitur nga nëpunësja ***** , e cila ka ngritur pretendimin për shkelje të rregullave procedurale dhe të dispozitave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në zhvillimin e procedurës së transferimit të përhershëm për shkak ristrukturimi, nga pozicioni “Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimit Social”, në Bashkinë Klos – kategoria e pagës II-b, në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, në Bashkinë Klos – kategoria e pagës III-a/1.

Nga hetimi administrativ i kryer rezulton e vërtetuar se, nëpunësja civile ***** ka qenë e punësuar në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimit Social*”, në Bashkinë Klos, deri në momentin kur me urdhrin nr. 17, datë 05.02.2020, të Kryetarit të Bashkisë, “*Për miratimin e strukturës dhe organigramës së Bashkisë Klos për vitin 2020*”, është miratuar struktura e re dhe numri i përgjithshëm i punonjësve për këtë institucion.

Për implementimin e kësaj strukture në zbatim të nenit 50, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për Bashkinë Klos, me urdhrin nr. 20, datë 07.02.2020, ka krijuar Komisionin e Ristrukturimit, i cili rezulton të ketë njoftuar nëpunësen në fjalë për fillimin e procedurës së ristrukturimit.

Komisioni i Ristrukturimit, pas shqyrtimit dhe analizës së ndryshimeve strukturore, dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil, si dhe përshkrimet e punës për pozicionet e reja të krijuara, me aktin nr. 472 prot., datë 14.02.2020, ka propozuar përfundimin e marrëdhënies së punësimit të nëpunëses ***** nga pozicioni “*Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimit Social*”, në Bashkinë Klos – kategoria e pagës II-b dhe transferimin e saj në pozicionin “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, në Bashkinë Klos – kategoria e pagës III-a/1.

Në përmbajtje të aktit të mësipërm, si dhe procesverbalit të mbajtur nga ky komision, vërehet se transferimi i kësaj nëpunëses në një pozicion të kategorisë së ulët drejtuese, është kryer për shkak se drejtoria ku punonte më parë kjo punonjëse është ulur një kategori duke u shndëruar në sektor, gjë e cila ka sjellë si rrjedhojë suprimimin e pozicionit “*Drejtor në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimit Social*”. Në referencë të pozicioneve të reja të krijuara, Komisioni i Ristrukturimit, ka arritur në konkluzionin se, kjo nëpunëse plotëson kërkesat përgjithshme dhe të posaçme për të mbajtur pozicionin e punës “*Përgjegjës i Sektorit të të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave*”.

Më tej, në zbatim të Kreut II, pika 20, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar, njësia përgjegjëse e Bashkisë Klos me aktin nr. 810 prot., datë 17.03.2020, ka njoftuar nëpunësen për transferimin e saj në pozicionin e propozuar nga Komisioni i Ristrukturimit, duke i kërkuar deklarin për pranimin ose jo të pozicionit, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së njoftimit.

Në kushtet e mësipërme, nëpunësja ***** duke mos qenë dakord me transferimin, ka paraqitur ankim më datë 24.03.2020, pranë Departamentit të Administratës Publike (protokolluar me nr. 1667 prot., datë 26.03.2020), duke kërkuar vlerësimin e ligjshmërisë të aktit të transferimit. Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 1667/1 prot.,

datë 14.04.2020, ka sqaruar nëpunësen se ankimi i saj në lidhje me transferimin e përhershëm për shkak ristrukturimi, duhet të paraqitet pranë njësisë përgjegjëse të Bashkisë Klos dhe jo pranë DAP, pasi ky i fundit nuk e ka cilësinë e njësisë përgjegjëse për institucionet e pushtetit vendor.

Duke analizuar gjithë sa u parashtrua më sipër dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar nga institucioni në kuadër të verifikimit të rastit, arrihet në përfundimin se gjatë zhvillimit të procedurës së transferimit të përhershëm për shkak ristrukturimi, nga njësia përgjegjëse e Bashkisë Klos janë kryer/lejuar disa shkelje, të cilat parashtrohen më poshtë:

Së pari, në nenin 50, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, përcaktohet se, nëse për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, pozicioni i mëparshëm i një nëpunësi civil nuk ekziston më, ai transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori.

Më tej, në pikën 2, të po këtij neni përcaktohet se: “transferimi, sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet me precedencë, sipas kësaj renditje: a) në të njëjtin institucion, ku nëpunësi civil është i emëruar; ... c) në një institucion tjetër të shërbimit civil”.

Në rastin konkret, Komisioni i Ristrukturimit ka propozuar transferimin e nëpunëses ***** në një pozicion të nivelit të ulët drejtues, me kategori page III-a/1, ndërkohë që para momentit të ristrukturimit rezulton se kjo nëpunëse ka qenë e emëruar në një pozicion të nivelit të mesëm drejtues, me kategori page II-b. Megjithatë, vlerësohet se ky veprim i Komisionit të Ristrukturimit, ka qenë i diktuar nga fakti se pozicioni i ri i punës, në përmbajtje është i njëjtë me atë të mëparshmin, por organi kompetent që ka hartuar strukturën e re, ka vendosur që të ulë kategorinë e pozicionit të punës. Pra, në thelb, kjo nëpunëse do të kryejë të njëjtën punë si më parë, veçse tashmë, pozicioni do të jetë një kategori më poshtë.

Së dyti, në pikën 20, të Kreut II, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, përcaktohet se:

“Njësia përgjegjëse, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së propozimit nga Komisioni i Ristrukturimit, vendos për transferimin e nëpunësit civil, njofton nëpunësin civil për vendimin dhe merr mendimin e tij me shkrim. Nëpunësi civil duhet të japë mendimin e tij me shkrim brenda 5 ditëve nga data e marrjes së njoftimit”.

Në rastin konkret, rezulton se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Klos nuk ka respektuar detyrimin e mësipërm ligjor, duke mos materializuar datën e marrjes dijeni prej nëpunëses në fjalë të vendimit të transferimit, si dhe dhënien e mendimit prej saj. Për më tepër, konstatohet se kjo nëpunëse, nuk ka qenë dakord me këtë transferim, ku në interpretim të

gabuar të ligjit, ka kërkuar shqyrtimin e kësaj vendimmarrjeje nga Departamenti i Administratës Publike.

Në respektim të dispozitave të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, detyrimi i njësisë përgjegjëse për të marrë mendimin me shkrim të nëpunësit, ekziston edhe në rastet kur transferimi i tyre është kryer në pozicion të së njëjtës kategori. Në vijim të këtij arsytimi, njësia përgjegjëse duhet të sigurojë marrjen e mendimit, sidomos për ata nëpunës, të cilët për shkak të ristrukturimit transferohen në një pozicion të shërbimit civil të një kategorie më të ulët.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil kërkon të theksojë se, legjislacioni për shërbimin civil, nuk lejon transferimin e një nëpunësi në pozicione të shërbimit civil të një kategorie me të ulët. Kjo është një artificë, që është lejuar për t’i ardhur në ndihmë nëpunësit civil për të mos t’ju shkëputur marrëdhënia e punësimit dhe ajo financiare, në kushtet kur transferimi i tij në një pozicion të barasvlershëm është absolutisht i pamundur. Por që ky veprim të ligjërohet, kërkon domosdoshmërisht miratimin e dhënë prej tij. Nëse do të ishte kërkuar shprehja e mendimit nga nëpunësja në rastin konkret dhe ajo do të refuzonte në pa shkaqe të ligjshme transferimin, atëherë në eventualitetin e pamundësisë së sistemimit të saj në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori, në bazë të pikës 1/a, të nenit 66, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, duhej vendosur lirimi i saj nga shërbimi civil.

Megjithatë, në referencë të listëprezencës dhe listëpagesës së muajit mars dhe prill 2020, nga ku konstatohet se marrëdhënia e punësimit për nëpunësen ******, ka vijuar në Bashkinë Klos në pozicionin e ofruar, Komisioneri vlerëson se kjo nëpunëse, me veprime konkludente ka pranuar transferimin e saj në këtë pozicion. Në këto kushte, njësia përgjegjëse e institucionit duhet të plotësojë dosjen e saj me aktin që materializon pranimin e saj për transferimin në pozicionin *“Përgjegjës i Sektorit të të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave”* në Bashkinë Klos.

Nëse nëpunësja në fjalë do të refuzojë dhënien e pëlqimit për këtë transferim, njësia përgjegjëse duhet të marrë masa për të sqaruar dhe informuar atë për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes së lindur, sipas përcaktimeve të nenit 66, pika 1, germa *“a”*, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për Bashkinë Klos, duhet të plotësojë procedurën e transferimit për shkak të ristrukturimit, duke marrë mendimin me shkrim prej nëpunëses *****, për transferimin e saj të përhershëm në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, në Bashkinë Klos – kategoria e pagës III-a/1. Në eventualitetin që kjo nëpunëse nuk do të shprehë pëlqimin për mbajtjen e pozicionit të ofruar, të vepohet sipas përcaktimeve të nenit 66, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
2. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Klos, të zbatojë vendimin brenda 5 ditëve nga data e marrjes dijeni dhe pas përfundimit të këtij afati të njoftojë me shkrim Komisionerin për zbatimin e vendimit.
3. Të njoftohet për këtë vendim paralajmërues Kryetari i Bashkisë Klos, njësia përgjegjëse e këtij institucioni dhe nëpunësja *****.
4. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha